

# **MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

**midis**

**Komisionerit për të Drejtat e Njeriut (Ombudsman) i Republikës së  
Azerbajxhanit**

**dhe**

**Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
të Republikës së Shqipërisë**

Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet midis Komisionerit për të Drejtat e Njeriut (Ombudsman) i Republikës së Azerbajxhanit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Shqipërisë, për të nxitur bashkëpunimin dhe krijimin e marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes së të drejtës për akses në informacion.

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është përcaktimi i një kuadri për bashkëpunim midis palëve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si edhe aksesit në informacion dhe shkëmbimit të praktikave më të mira në fushat përkatëse.

2. Ky Memorandum mbulon fushat e interesit dhe sfidave të përbashkëta, përfshirë por pa u kufizuar në:

- Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut;
- Mbrojtjen e të drejtës për akses në informacion;
- Shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës;
- Rritjen e kapaciteteve dhe trajnime;
- Bashkëpunimin në hetime dhe kontrolle.

3. Palët, brenda kompetencave së tyre, bien dakord të shkëmbejnë informacion, dokumente dhe ekspertizë lidhur me fushat përkatëse të përgjegjësisë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë çështjet e konfidencialitetit.

4. Palët mund të organizojnë aktivitete të përbashkëta, trajnime për rritje kapacitetesh, seminare dhe evente, qoftë duke u takuar fizikisht apo *online*, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e anëtarëve të stafit të tyre përkatës mbi të drejtat e njeriut dhe të drejtën për akses në informacion.

5. Palët mund të bashkëpunojnë në kryerjen e hetimeve dhe kontrolle në lidhje me çështjet që i përkasin fushave të tyre të përgjegjësisë të tyre, duke iu nënshtruar ligjeve dhe rregulloreve në fuqi që rregullojnë këto fusha.

6. Palët do të krijojnë një mekanizëm për të lehtësuar bashkëpunimin dhe komunikimin efektiv, përfshirë takime të vazhdueshme dhe shkëmbim të pikave të kontaktit.

7. Palët do të zhvillojnë dhe zbatojnë reciprokisht programet e vizitave, praktikave dhe trajnimeve të tjera për të shkëmbyer përvojën dhe ekspertizën në takime dypalëshe dhe shumëpalëshe e gjithashtu do të realizojnë takime ndërmjet Komisionerit për të Drejtat e Njeriut (Ombudsman) të Republikës së Azerbajxhanit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Shqipërisë, si dhe të stafit të tyre.

8. Ndryshimet dhe shtesat në këtë Memorandum mund të kryhen, nëse do të jetë e nevojshme, me pëlqimin reciprok të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut (Ombudsmanit) të Republikës së Azerbajxhanit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimet apo shtesat zbatohen me protokolle të veçanta, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij Memorandumi.

9. Memorandumi nuk është një traktat ndërkombëtar dhe nuk krijon për Palët asnjë të drejtë dhe detyrim të rregulluar nga e drejta ndërkombëtare. Të gjitha mosmarrëveshjet për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të Memorandumit duhet të zgjidhen përmes negociatave dhe konsultimeve ndërmjet Palëve.

10. Memorandumi do të jetë në fuqi nga data e nënshkrimit deri në tre muaj nga data e marrjes së njoftimit me shkrim nga njëra Palë për qëllimin e Palës tjetër për të zgjidhur atë.

Nënshkruar në Tiranë, Shqipëri më 5 qershor 2024, në dy kopje në gjuhën shqipe, anglishte dhe azere. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin, zbatimin apo implementimin e çdo përmbajtjeje të Memorandumit, Palët do t'i referohen versionit në anglisht.

**Sabina Aliyeva**

**Komisioner për të Drejtat e  
Njeriut (Ombudsman) i  
Republikës së Azerbajxhanit**

**Besnik Dervishi**

**Komisioneri për të Drejtën e  
Informimit dhe Mbrojtjen e të  
Dhënave Personale i Republikës së  
Shqipërisë**